



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Nr. 2249 Prot.

Lezhë 19.08.2022

URDHËR

Nr. 174 Datë 19.08.2022

PËR

***SHPALLJEN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT
“PËR PUNONJËS TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË JURIDIKSION TË
DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË***

Në zbatim të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.7961 dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funksonimin e Institucioneve Arsimore” Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial” ndryshuar me Urdhër e MAS nr. 461, datë 27.07.2022, “Për një Ndryshim në Urdhër 313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e procedurave të konkurrimit për punonjës të shërbimit psiko-social në institucionet arsimore publike në juridiksion të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë.
2. Kandidatët e interesuar duke filluar nga data **22.08.2022**, mund të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar sipas shpalljes në vijim nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Lezhë.
3. Vendet e lira për konkurrim psikolog/punonjës social, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

Adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti” Godina QKF “Gjergj Laca”, kati II, email DRAPLezhe@arsimi.gov.al

4.Kriteret për t`u punësuar në shërbimin psiko-social:

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative, apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse.
3. Njohuri bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi,certifikata).
5. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

I. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale – Jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për (pjesëmarrje në konkurrim) për punësim në **Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar** ku dëshirojnë të aplikojnë për për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e Diplomës/diplomave (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
5. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
6. Leje për ushtrimin individual të profesionit - kopje e njehsuar me origjinalin (licencë);
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga aplikanti sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
8. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
10. Librezë pune fotokopje e noterizuar nëse ka;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e tre muajve të fundit (e detyrueshme);
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme);
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (detyrueshme).

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti" Godina QKF " Gjergj Lacaj" , kati II, email DRAPLezhe@arsimi.gov.al


- B. Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara. Nëse në dosjen e aplikimit mungon një nga dokumentat e detyrueshme atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.
- C. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Lezhë, për të gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim në ZVAP-et në varësi të DRAP Lezhë, përkatëse brenda afatit 22.08.2022 - 31.08.2022
- II. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social të paraqitur në dosje, do të kryhet nga komisioni në periudhën 06.09.2022 – 08.09.2022
- Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor dhe në faqet zyrtare të ZVAP-ve dhe DRAP Lezhë në datë 08.9.2022 ;
 - Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) brenda datës 09.09.2022 .
 - Në datë 12.09.2022, shpallet lista përfundimtare e kandidatëve që kalojnë fazën e parë (I) të shqyrtimit të dokumentacionit .
- III. Njoftimi për testimin me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit, për kandidatët që kanë kaluar vlerësimin me dosje, do të njoftohet nga DRAP Lezhë me një lajmërim të dytë.
- Kandidatët pas publikimit të rezultateve të testimit do të dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultateve të tyre.
- IV. DRAP Lezhë në njoftim në faqet zyrtare shpall listën e kandidatëve të kualifikuar dhe grafikun e intervistave të strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim.
- V. Në përfundim të intervistës, komisioni ad-hoc shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës-social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej, (pikët e dosjes + pikët e testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen e institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

DREJTORI



Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti" Godina QKF "Gjergj Laca", kati II, email DRAPLezhe@arsimi.gov.al



NR DRAP	ZVAP	INSTITUCIONI ARSIMOR	NUMRI NXENE SVE	VENDE TE LIRA SIPAS URDHERIT 461 DATE 27.07.2022			
				PSIKOLOG		PUNONJES SOCIAL	
				KONTRATE PA AFAT	RAP.MJEKESOR, LEJE LINDJE ETJ	KONTRATE PA AFAT	RAP.MJEKESOR, SOR, LEJE
1	LEZHË	MALËSI E MADHË MUHAMET HASMUJA, MYFTAR MATAJ , DED GJON LULI	386	1			
2	LEZHË	9 - VJECARE NENE TEREZA, 9 - VJECARE DODE GEGE JAKU, SHMB GIOVALIN GIADRI	500	1			
3	LEZHË	9 - VJECARE NENE TEREZA, 9 - VJECARE DODE GEGE JAKU, SHMB GIOVALIN GIADRI	397	1			
4	LEZHË	9 - VJECARE KOLEC MEKSHAJ, 9 - VJECARE GRYKE LUMI, SHMB UNGREJ, SHMB KALLIVAQ	425	1			
5	LEZHË	9 - VJECARE SHTJEFEN GJECOVI, 9 - VJECARE TOROVICE, SHMB FRANG BARDHI	620	0		1	
6	LEZHË	9 - VJECARE GJERGJ KASTRIOTI	465	0			
7	LEZHË	9 - VJECARE AT ZEF PLLUMI, 9 - VJECARE FRAN IVANAJ	263	1			
8	LEZHË	MIGJENI	366	1	0		
9	LEZHË	SHKOLLA 9 VJECARE RRËSHEN 2	465	1			
10	LEZHË	9 VJEÇ."BESNIK SYLA" MAMURRAS, KOP.NR.1 MAMURRAS	319	1			
11	LEZHË	9 VJEÇ.MILOT,KOPSHITI MILOT	329	1			
12	LEZHË	9 VJEÇ."NIK TOM PRELA" GORRE, KOPSHITI GORRE	349	1			
13	LEZHË	9 VJEÇ."DEMOKRACIA", "ADEM MYRTA", "FRAN PAL, PIROLI"	346	1			
14	LEZHË	9 VJEÇ."28 NËNTORI" F.MILOT, "CUB ÇOPANI" MAL BARDHË	284	1			
15	LEZHË	9 VJEÇ.ADRJATIK,F.KUQE,KOPSHITI NR.2 MAMURRAS	369	1			
16	LEZHË	9 VJEÇ."GJON GJONAJ", KOPSHITI NR.2 LAÇ	502	1		1	
17	LEZHË	GJIMNAZI "SKENDERBEU" KRUME	764	1			
18	LEZHË	9-VJECAREE "SEJDI DIDA" KRUMË	383	1			
19	LEZHË	SHMB "IMER MATA" ZAPOD, 9-VJECARE "HAMDI PELIVANI" ORGOST, KOPSHITET ZAPOD DHE O	429	1			
20	LEZHË	SHMB BUSHTRICË, 9-VJECARE "SALI BRUKA" MALQENE, 9 VJECARE "SHABAN MURATI" LUSEN,	332	1			
21	LEZHË	SHMB SHEMRI DHE SHKOLLAT VARTËSE, 9-VJECARE KALIMASH DHE SHKOLLA VARTËSE	329	1			
22	LEZHË	9-VJECARE FSHAT DHE SHKOLLAT VARTËSE, 9-VJECARE KALIS DHE SHKOLLAT VARTËSE, 9-V	578	1		1	
23	LEZHË	9-VJECARE "LIDHJA E PRIZRENIT" KUKËS	772	1			
24	LEZHË	9-VJECARE "AVNI RUSTEMI" KUKËS	286	1			
25	LEZHË	GJIMNAZI NËNË TEREZA (9-VJECARE SHABAN BANUSHI)	324	1			
26	LEZHË	SHMB "HASAN METI" MJEDE, (9-VJECARE NARAÇ)	360	1			
27	LEZHË	9-VJECARE KOSMAÇ (9-VJECARE ALEKSANDER PALOCI, SHMB PISTULL)	475	1			
28	LEZHË	ALI IBER NEZA(KASAJ, LUGI I TROPOJËS), HAXHI ZENUNI (GEGAJ), XHELADIN	329				
29	LEZHË	GOSTURANI(HYSNI ZAJMI, MYHEJAN), MURAT PACI(BERISHË)	344				
30	LEZHË	KONFERENCA E BUJANIT ,OSO DAUTI (LUZHË) , HOXHË ZOGU (KEPENEK, PRUSH)	797	1			
31	LEZHË	LEKË ÇOKAJ,MUSHAK KADRIA, HAXHI ZEKË BYBERI (DRAGOBI,VALBONË),JAHO	412				
32	LEZHË	SALIH (GRI,VATOC)	328				
33	LEZHË	NDRE MJEDA	346				
34	LEZHË	LIRIA + SHKOLLA VARTËSE DHE TRING SMAJLI	357				
35	LEZHË	SHTOJ I RI, SHTOJ I VJETËR, ISMET SALI BRUÇAJ	597				
36	LEZHË	DRISHT + SHKOLLA VARTËSE, DRAGOÇ +SHKOLLA VARTËSE, BRUÇAJ DHE SHKOLLA VARTËSE	556	1			
37	LEZHË	GJERGJ VAT MARTINI + SHKOLLA VARTËSE, LUCE AGRAJA+SHKOLLA VARTËSE, PJETER GACI	443	1			
38	LEZHË	OSO KUKA	353				
		BRANKO KADIJA					
		XHELADIN FISHTA					
		QAZIM MEHIA DHE HASAN DARDHANJORI, MEHMET SHPENDI					